VENDIM
Nr. 198, datë 2.5.1997

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.621, DATË 20.12.1993 "PËR KOMPETENCAT NË DHËNIEN E LEJEVE PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARIVE NË FUSHËN E TRANSPORTIT", NDRYSHUAR ME VENDIMIN NR.763, DATË 11.11.1996

Me propozimin e Ministrisë së Industrisë, Transportit dhe Tregtisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.621, datë 20.12.1993, ndryshuar me vendimin nr.763, datë 11.11.1996, bëhen këto ndryshime:

- Titulli ndryshohet si vijon:

"Për kompetencat në dhënien e lejeve për ushtrimin e veprimtarive në fushën e transportit dhe të industrisë".

- Pika 1 ndryshohet si vijon:

"Ministria e Industrisë, Transportit dhe Tregtisë përcakton rregullat përkatëse për kriteret, kushtet dhe procedurat për lëshimin e lejeve të ushtrimit të veprimtarive në fushat e transportit e të industrisë, si dhe për masat që merren për shkeljen e tyre".

- Pika 2 ndryshohet si vijon;

"Lejet për ushtrimin e veprimtarive në fushën e transportit dhe të industrisë lëshohen nga organet sipas listës që i bashkëngjitet këtij vendimi".

- Në pikat 3 dhe 4 fjalët "Ministria e Transporteve" të zëvendësohen me fjalët "Ministria e Industrisë, Transportit dhe Tregtisë".

2. Lista që i bashkëngjitet vendimit të Këshillit të Ministrave nr.763, datë 11.11.1996, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Bashkim Fino

VEPRIMTARITË NË FUSHËN E TRANSPORTIT DHE TË INDUSTRISË, PËR TË CILAT KËRKOHET LEJE E LËSHUAR NGA:

A. Ministria e Industrisë, Transportit dhe Tregtisë

I. Në transportin rrugor:

1. Në transportin e udhëtarëve në linjat ndërqytetëse dhe ndërkombëtare.
2. Për transportin ndërkombëtar të mallrave.
3. Për veprimtarinë e shërbimit të agjencive të udhëtarëve, të mallrave dhe spedicionerëve.
4. Për përgatitjen dhe kualifikimin e drejtuesve të automjeteve.
5. Për veprimtarinë e kontrollit teknik periodik. Për veprimtarinë e kontrollit teknik periodik, së bashku me servis-riparimin.

Miratimi paraprak për veprimtarinë e servis-riparimit të subjekteve të huaja ose në bashkëpunim.

II. Në transportin detar, ujor dhe portet:

1. Për veprimtarinë për transportin detar të mallrave dhe/ose udhëtarëve midis porteve dhe pontileve detare brenda dhe atyre në transportin ujor (liqenet etj.).
2. Për transportin detar e ujor ndërkombëtar për mallra dhe/ose për udhëtarë.
3. Për shërbimet e agjencive detare, të pilotimit, spedicionit dhe ngarkim-shkarkimit në porte.

III. Në ushtrimin e veprimtarisë në fushën e industrisë:

1. Për industrinë mekanike (fonderi, përpunim pjesë këmbimi).
2. Për industrinë e përpunimit të lëkurë-këpucës, të gomës dhe të plastikës.

3. Për industrinë e konfeksioneve prej tekstilesh të pambukta, të leshta dhe përzierjeve të tyre.

4. Për industrinë përpunuese të drurit (lëndë të para, mobilie, detale).

5. Për industrinë e prodhimeve kimike të konsumit.

6. Për industrinë e prodhimit të qelqit dhe të qeramikës (fajancë, porcelan).

IV. Për ushtrimin e veprimtarive të lira në fushat e transportit dhe të industrisë:

1. Për ushtrimin e veprimtarisë së konsulencës teknike, projektimeve dhe shërbimeve teknike në fushat e transportit dhe të industrisë.

B. Nga këshillat e rretheve dhe bashkitë e qyteteve

I. Në fushën e transportit rrugor:

1. Në transportin qytetës dhe rrethqytetës të udhëtarëve me autobus dhe transportin taksi, sipas përcaktimeve të urdhëresës së Këshillit të Ministrave nr.7, datë 17.8.1993.

2. Për veprimtarinë e transportit të mallrave brenda vendit.

3. Për veprimtarinë e servis-riparimit të mjeteve të transportit rrugor, shërbimin dhe rimorkimin e mjeteve të difektuara në rrugë, larjen e automjeteve, parking, gomisteri etj.

II. Në fushën e transportit detar e ujor:

1. Për veprimtarinë në transportin e mallrave dhe të udhëtarëve në liqene brenda rrethit.

2. Për veprimtarinë në linjë me spontimin e mallrave nga anijet dhe kryerjen e mjeteve të transportit detar dhe ujor.

III. Në fushën e transportit hekurudhor:

1. Në veprimtarinë e shërbimeve të ndryshme për mallrat në stacione.